

**V E N D I M**  
**PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK**

Sot, më datë 21.1 2000 unë gjyqtari M. Draggy pranë Gjykatës së rrethit Tiranë, shqyrtova kërkesën e paraqitura nga kërkuesi **Gëzim Qinami**, për regjistrimin pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, në regjistrin tregtar, të Shoqërisë "**UNION** " **Sh.p.k. si person juridik.**

**KONSTATOVA:**

Se, kërkuesi **Gëzim Qinami**, i biri i Ramazanit, datëlindja 30. 04. 1946, lindur e banues në Tiranë, Rruga Zonja Çurre, Pall. 28, Shk. 2, Ap. 21, me cilësinë e ortakut të vetëm dhe administrator, kërkon regjistrimin si person juridik të Shoqërisë "**UNION** " Sh.p.k. të krijuar prej tij me kushtet e mëposhtme:

- Emërtimi i shoqërisë është "**UNION** " Sh.p.k.
- Ortak i vetëm dhe administrator do të jetë zoti **Gëzim Qinami**.
- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën **Rruga Zonja Çurre, Pall. 28, Shk. 2, Ap. 21, Tiranë.**
- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Import-eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë i aparaturave elektronike, kompjutera, fotokopjues, fakse, aparate telefonike e telefona celularë, televizorë, video, kamera, magnetofona, pjesë këmbimi e asistencë teknike për to, kompak-disqe, video-games; kamçeleri; artikuj mobilerie; mallra industriale; produkte ushqimore, pije alkolike e freskuese; pjesë këmbimi për automjete; transport mallrash të të gjitha llojeve për vete dhe për të tretët brenda dhe jashtë vendit.
- Kapitali fillestar do të jetë 100.000 lekë dhe do të depozitohet nga Ortaku i vetëm.
- Shoqëria private do ta zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 20 vjet. Veprimtaria e saj do të zhvillohet në Tiranë dhe do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj.

**Për këto arsye**

Në bazë të ligjit Nr. 7638, datë 19. 11. 1992

**V E N D O S A**

Pranimin e kërkesës.

Regjistrimin si person juridik të Shoqërisë me kushtet e mëposhtme:

- Emërtimi i shoqërisë është "**UNION** " Sh.p.k.
- Ortak i vetëm dhe administrator është zoti **Gëzim Qinami**.
- Selia e Shoqërisë është në adresën **Rruga Zonja Çurra, Pall. 28, Shk.2, Ap. 21, Tiranë.**
- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: Import-eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë i aparaturave elektronike, kompjutera, fotokopjues, fakse, aparate telefonike e telefona celularë, televizorë, video, kamera, magnetofona, pjesë këmbimi e asistencë teknike për to, kompak-disqe, video-games; kamçeleri; artikuj mobilerie; mallra industriale; produkte ushqimore, pije alkolike e freskuese; pjesë këmbimi për automjete; transport mallrash të të gjitha llojeve për vete dhe për të tretët brenda dhe jashtë vendit.

- Kapitali fillestar është 100.000 lekë dhe do të depozitohet nga Ortaku i vetëm.
  - Shoqëria private do ta zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 20 vjet.
- Veprimtaria e saj do të zhvillohet në Tiranë dhe do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Shkallës së Dytë.

Tiranë, më 21-1 2000

GJYQTARE

*Majlinda Daga*  
*Daga*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
Nr. 22.691/L

V E N D I M

“ I G J Y O T A R I T T E V E T E M ”

Une gjyqtarja e vetme, G. Bepi, ne gjykaten e Rrethit Tirane, sot ne daten 11. 09. 2000 mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga z. **Gezim QINAMI** per depozitimin e Vendimit Nr.1 date **04.09.2000** te Ortakut te vetem te Shoqerise “ **UNION** “ Sh.p.k. dhe

**K O N S T A T O V A :**

Se me Vendimin Nr. **22691** date **21.01.2000** eshte rregjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ **UNION** “ Sh.p.k. me Ortake z. **Gezim QINAMI** me Seli ne Tirane . Me Vendimin Nr. 1 te Ortakut te vetem te Shoqerise date **04.09.2000** eshte vendosur te behen keto ndryshime :

- Shitjen e 60 % te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise “ **UNION** “ Sh.p.k.
- Blerjen e kuotave perkatese te z. **Gezim QINAMI** nga Blereset **Natasha QINAMI** dhe **Edlira HASKAJ** ne masen 30 % sejcila .
- Blereset pranohen si Ortake te Reja ne Shoqerine **UNION Sh.p.k.**
- **Z. Gezim QINAMI** mbetet ne Shoqeri si Ortak duke disponuar 40 % te kuotave te kapitalit fillestar te Shoqerise dhe duke qene Administrator i kesaj Shoqerie . .
- Te ruaje te pandryshuara te gjitha dispozitat e tjera te paraqitura ne Statutin e Shoqerise.
- Te njoftohet Gjykata e Rrethit Tirane , per te bere ndryshimet perkatese ne regjistrin tregetar te Shoqerise .

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligje dhe si e tille duhet pranuar .

**PER KETO ARESYE**

Ne baze te ligjit Nr. 7512 date 10.08.1991 ,Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 , Ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 “ Per Regjistrin tregetar “.

**V E N D O S A :**

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin prane rregjistrin tregetar te Vendimit Nr. 1 date 04.09.2000 te Ortakut te Vetem te Shoqerise " UNION " Sh.p.k.
- Depozitimin e Kontrates se Shitjes se Kuotave me Nr. \_\_\_\_\_ Rep.date \_\_\_\_\_ tek noteri \_\_\_\_\_.
- Te ndahen regjistrimet nga njeri - tjetri me vije te kuqe , dhe te behen ndryshimet perkatese ne kollonat 4 dhe 5 .

**GJYQTARE**

Enxheta Bajro  
G. Bajro

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE  
NR. 22691/1 AKTI.

**V E N D I M**

**I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me date 12 / 11 / 2002, une M Dedi, Gjyqtare e vetme e Gjykates se rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e kerkuesit Z. Ardit Barbullushi, per shitblerjen e kuotave nga Ortaket e shoqerise "UNIONI " Shpk, dhe emerimit te tij administrator i vetem. Pasi shqyrtova kerkesen e tij,

**K O N S T A T O V A**

Shoqëria "UNIONI " Shpk., është regjistruar prane kesaj Gjykate me vendimin numer 22691, date 4 Shtator 2000. Shoqëria e ka seline në Tirane. Kohëzgjatja e veprimtarisë është mbi 20 vjet. Shoqëria ka një kapital fillestar prej 100.000 (njqindmije) lekë me Administor te Shoqerise Z. Gezim Qinami:

Me vendimin Nr. 22691/1, date 11 Shtator 2000, Shoqeria ka bere keto ndryshime:  
Znj. Natasha Qinami dhe Znj. Edlira Haskaj jane pranuar si ortake me blerjen e kuotave te kapitalit Ortakut te vetem Z. Gezim Qinami, ne masen nga 30% te kapitalit secila.  
Oratake te Shoqerise jane:

1. **Gezim Qinami**, i cili zoteron 40% të kapitalit ose 40 kuota, ku vlera nominale e një kuote është 1.000 lekë.
2. **Natasha Qinami**, e cila zoteron 30% të kapitalit ose 30 kuota, ku vlera nominale e një kuote është 1.000 lekë.
3. **Edlira Haskaj**, e cila zoteron 30% të kapitalit ose 30 kuota, ku vlera nominale e një kuote është 1.000 lekë.

Me date 1.11.2002, eshte mbledhur rregullisht Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve me pjesmarrjen e te tre Ortakeve. Ne kete mbledhje u vendos:

- Shitja e 20 kuotave te Ortakut Gezim Qinami, Z. Ardit Barbullushi.
- Shitja e 20 kuotave te Ortakes Natasha Qinami, Z. Ardit Barbullushi.
- Emerimi i Z. Barbullushi Administrator i Vetem i Shoqerise.
- Te ndryshme.

Me vendimin e Asamblese se Ortakeve date 1.11.2002, dhe ne baze te nenit 23 dhe 49 te ligjit "Per Shoqerite Tregtare", ortaket vendosen miratimin e transferimit te 20 prej kuotave te Ortakut Gezim Qinami tek Ortaku i ri Ardit Barbullushi, miratimin e transferimit te 20 prej kuotave te Ortakes Natasha Qinami tek Orataku i ri Ardit Barbullushi, i cili behet zoterues i 40 % te kapitalit te Shoqerise, si dhe emerimin e Ardit Barbullushi Administrator i Vetem i Shoqerise.

Me date 4.11.2002, eshte lidhur Kontrata e Shitblerjes se kuotave.

### **PER KETO ARSYE**

dhe ne baze te ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe Formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare", si dhe ligjit 7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare".

### **VENDOSA**

Depozitimim ne regjistrin tregtar te Vendimit te Asamblese se Jashtezakoshme te Ortakeve te shoqerise "UNIONI " Shpk. Date 1.11.2002, kerkeses drejtuar gjykates, si dhe te dokumentave te tjera shoqeruese.

Urdherimin e zyres se regjistrin tregtar te beje ndyshimet perkatese me nr. rendor ....., ne kollonen .....<sup>4</sup>.....duke bere vijezimet me boje te kuqe.

Tirane, me, 12 / 11 / 2002

**GJYQTARE**

*Mariane Deo,*

*[Signature]*

Verzeichnis des Bestandes

1. Nr. 2269

2. Name: Union für die

3. Selb. - Union für die Union, Seite 28  
Nr. 2 Ap. 21

4. Objekte: Transportobjekt wie Union e pp  
Bücher, apparatbause, elektronik, Koffer, etc.  
falsch, apparat telefon etc.

5. Hauptort - 100000 belg

6. Administrativ - jedem Datum i. dem Union  
Datum, dt. 1916, Union Union Union  
R. Z. Union Seite 28 / 2 / 21  
Ort: Union

7. Höhegratz, im 20. Jhr

Statut: 6 Jhr

akt. Krenelun 2 Jhr

akt. neustatut 21. 1. 2000

akt. Verfassung 21. 1. 2000

Administrativ in Frankfurt

dt. 21. 1. 2000, per d. d. d. d.

Union Union Union

Prof. Dr.  
Herr  
Herr

# AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË PRIVATE "UNION " SH.P.K.TIRANË

Në bazë të ligjit Nr. 7638, datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe të Ligjit 7667, datë 28. 01, 1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare", sot në datë 21. 01. 2000, shtetasi:

**Gëzim Qinami**, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me vullnetin e tij të plotë, vendosi të krijojë Shoqërinë private me Përgjegjësi të Kufizuar : "UNION " SH.P.K.

## H Y R J E

Ortaku i vetëm ka të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga veprimtaria e Shoqërisë. Qëllimi i këtij Akti është themelimi i Shoqërisë Private "UNION " SH.P.K.

## OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë private "UNION " Sh.p.k. do të jetë: Import-eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë i aparaturave elektronike, kompjutera, fotokopjues, fakse, aparate telefonike e telefona celularë, televizorë, video, kamera, magnetofona, pjesë këmbimi e asistencë teknike për to, kompak-disqe, video-games; kamceleri; artikuj mobilerie; mallra industriale; produkte ushqimore, pije alkolike e freskuese; pjesë këmbimi për automjete; transport mallrash të të gjitha llojeve për vetë dhe për të tretët brenda dhe jashtë vendit.

## SELIA

Shoqëria private do ta ketë selinë e saj në Tiranë, Rruga Zonja Çurre, Pall. 28, Shk. 2, Ap. 21.

## AFATI

Shoqëria private themelohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një periudhë mbi 20 vjet, duke filluar nga koha e regjistrimit në regjistrin tregtar të Gjykatës së Tiranës. Për shkaqe e arsye të ndryshme, ajo mund të mbarojë aktivitetin e saj dhe para këtij afati. Kjo do të bëhet në përputhje me normat e Statutit dhe Legjislacionit në fuqi.

## KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali bazë i themelimit të Shoqërisë private përbëhet nga kapitali themeltarë i investuar nga ortaku i vetëm Zoti Gëzim Qinami dhe është **100.000 (njëqind mijë) lekë**.

Ortaku i vetëm është përgjegjës ndaj Shoqërisë private për të gjitha detyrimet e marra përsipër dhe përgjigjet për humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Fondet monetare të Shoqërisë private mund të përdoren për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së saj ekonomiko financiare.

## ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të administrohet nga ortaku i vetëm Zoti Gëzim Qinami, në përputhje me Statutin dhe dispozitat respektive të Ligjit 7638 datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare".



Rregullat për funksionimin dhe drejtimin e shoqërisë janë përcaktuar në Statutin e Shoqërisë private që shoqëron këtë Akt Themelimi.

Të gjitha mosmarrëveshjet me organet shtetërore, personat juridikë e fizikë, vendas e të huaj, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

Ky Akt Themelimi përpilohet në katër kopje, duke patur secila kopje fuqi të plotë ligjore dhe nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm, me vullnetin e tij të lirë e të plotë. Nga këto një kopje do të depozitohet tek noteri, një kopje për t'u regjistruar tek dega e tatimeve dhe kopja tjetër do të qëndrojë në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**THEMELUESI**  
**Gëzim QINAMI**

*Gëzim Qinami*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË


Nr. 111 Prot.

Nr. 23 Kol.

**V È R T E T I M**

Sot, në datë 21. 01. 2000 (dymijë), para meje noterit, u paraqit personalisht shtetasi **Gëzim Qinami**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i njohur prej meje, i cili deklaroi se sa më sipër është akti i themelimit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "**UNION** " **SH.P.K.** i hartuar me vullnetin e tij të lirë e të plotë, e nënshkruan rregullisht para meje dhe unë noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTER



# STATUT

## I SHOQËRISË PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "UNION " SH.P.K.

### HYRJE

#### NENI 1

Shoqëria Tregtare me përgjegjësi të kufizuar "UNION " SH.P.K. krijohet mbi bazën e iniciativës dhe kapitalit themeltar të ortakut të vetëm, Zotit Gëzim Qinami në bazë të aktit të themelimit datë 21. 01. 2000 për të ushtruar aktivitetin e saj privat si person juridikë i pavarur.

#### NENI 2

Shoqëria krijohet dhe e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me normat e këtij Statuti, Ligjit 7638 datë 19. 11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe Legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

#### NENI 3

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, i përballon humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kapitalit themeltar.

### EMËRTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

#### NENI 4

Emërtimi i Shoqërisë private është: "UNION " SH.P.K.

#### NENI 5

Shoqëria private ka qendrën e saj në Tiranë, Rruga Zonja Çurre, Pall. 28, Shk. 2, Ap. 21. Aktiviteti i Shoqërisë private mund të shtrihet në të gjithë territorin shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, duke hapur filiale, degë, përfaqësi e agjensi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### O B J E K T I

#### NENI 6

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë private "UNION " Sh.p.k. do të jetë: Import-eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë i aparaturave elektronike, kompjutera, fotokopjues, fakse, aparate telefonike e telefona celularë, televizorë, video, kamera, magnetofona, pjesë këmbimi e asistencë teknike për to, kompak-disqe, video-games; kamçeleri; artikuj mobilerie; mallra industriale; produkte ushqimore, pije alkolike e freskuese; pjesë këmbimi për automjete; transport mallrash të të gjitha llojeve për vete dhe për të tretët brenda dhe jashtë vendit.

#### NENI 7

Shoqëria private themelohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një periudhë mbi 20 vjet, duke filluar nga koha e regjistrimit në regjistrin tregëtar të Gjykatës së Tiranës. Për shkaqe e arsye të ndryshme, ajo mund të mbarojë aktivitetin e saj dhe para këtij afati. Kjo do të bëhet në përputhje me normat e Statutit dhe Legjislacionit në fuqi.



## KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

### NENI 8

Kapitali themeltarë i Shoqërisë përbëhet nga kontributi i ortakut të vetëm, Zotit Gëzim Qinami, me shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

### NENI 9

Kapitali i Shoqërisë private depozitohet në një nga bankat e Tiranës, para fillimit të aktivitetit të Shoqërisë.

### NENI 10

Kapitali themeltar mund të shtohet ose të zvogëlohet, në varësi të rezultateve dhe në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi. Ai mund të jetë në lekë ose në valutë të huaj.

### NENI 11

Kapitali themeltar mund të transferohet jashtë Shoqërisë, ose të lihet peng, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### NENI 12

Kapitali themeltar është lehtësishtë i transferueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkëshorti, paraardhësit dhe pasardhësit mund të bëhen ortakë në Shoqëri nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj.

### NENI 13

Shoqëria mund të ketë dhe kontribute të tjera në natyrë. Këtu përfshihen të gjitha sendet e paluajtëshme në shërbim të Shoqërisë si dhe ato të luajtëshme, të cilat kalojnë në pronësi të Shoqërisë.

## FONDET E SHOQËRISË

### NENI 14

Shoqëria përcakton fondet:

- Fondi themeltar (qarkullues);
- Fondi rezervë;
- Fonde të tjera, që mund të jenë të nevojshme gjatë veprimtarisë së saj.

Madhësia e secilit fond përcaktohet mbi bazën e vendimit të organit drejtues, i cili merr vendim gjithashtu edhe për qëllimin e përdorimit të tij.

## DREJTIMI ADMINISTRATIV

### NENI 15

Përsa kohë Shoqëria përbëhet nga një ortak i vetëm, si organ drejtuesë i saj do të jetë ortakut i vetëm Zoti Gëzim Qinami, që njëkohësisht do të jetë dhe administrator i saj.

### NENI 16

Ortakut i vetëm, për administrimin e Shoqërisë ose të aktiviteteve të veçanta të saj ka kompetencë të emërojë një ose disa persona të tjerë si administratorë të Shoqërisë. Kompetencat e administratorëve të mundshëm përcaktohen në aktin e emërimit të tyre, të lëshuar nga ortakut i vetëm.



### **NENI 17**

Shoqëria nuk merr përsipër veprimet që mund të kryejnë administratorë të tjerë të mundshëm, në marrëdhënie me persona të tretë që i tejkalojnë kompetencat e tyre të përcaktuara në aktin e emërimit.

### **NENI 18**

E gjithë veprimtaria e Shoqërisë përcaktohet nga administratori i saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.

### **Neni 19**

Administratori për të shqyrtuar bilancin vjetor, të ardhurat e qarkulluara, si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave të veprimeve kontabël, emëron një ose disa ekspertë kontabël. Emërimi i ekspertëve kontabël është i detyrueshëm për rastet e parashikuara me ligj.

## **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

### **NENI 20**

Për sa kohë që Shoqëria private do të përbëhet nga një ortakë i vetëm, kompetencat e administratorit të saj do të jenë:

- Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë dhe miraton rregulloret për sektorët e veçantë të saj.
- Emëron dhe shkarkon administratorët dhe përcakton kompetencat e tyre në aktin e emërimit.
- Shqyrton bilancin vjetor, kuotat e fondeve të ndryshme dhe fitimin e realizuar.
- Vendos për krijimin e filialeve, degëve ose përfaqësive të Shoqërisë si dhe për krijimin e shoqërive të përbashkëta.
- Vendos për marrjen e kredive si dhe për mbarimin e aktivitetit të Shoqërisë, nëse në dokumentacionet financiare, rezultatet e Shoqërisë vlerësohen me humbje.
- Realizon marrëdhëniet më të rëndësishme financiare dhe ekonomike të Shoqërisë me persona të tjerë fizikë dhe juridikë.
- Realizon dhe përcakton çmimet e punimeve të kryera si dhe të shitjeve të artikujve të tregtuar.
- Vendos për pagat e personelit të Shoqërisë.
- Ndjek problemet e Shoqërisë në marrëdhëniet me organe të ndryshme shtetërore dhe me persona të tjerë fizikë dhe juridikë.

## **MARRËDHËNIET FINANCIARE**

### **NENI 21**

Shoqëria private me përgjegjësi të kufizuar "UNION " SH.P.K., mund të lidhë kontrata me sektorë shtetërorë, drejtpërdrejt me tregun e lirë, si dhe me persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj.

### **NENI 22**

Në marrëdhëniet kontraktore, Shoqëria përfaqësohet nga ortaku i vetëm ose nga persona të autorizuar prej tij. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për Shoqërinë.

### **NENI 23**

Shoqëria ka të drejtë të plotë të çelë llogari likuiduese pranë Bankave të vendit ose të huaja në Shqipëri, shtetërore ose private dhe të kryejë veprimet e likuidimit nëpërmjet

tyre. Për sigurimin e veprimtarisë ka të drejtë të vetëfinancohet në lekë ose në valutë të huaj.

#### **NENI 24**

Shoqëria përgjigjet për kontributet fiskale, afatet e derdhjes së tyre dhe sigurimet shoqërore. Personat e ngarkuar me këtë detyrë duhet të mbajnë dokumentacion të rregullt financiar.

Administratori në fund të vitit duhet të dorëzojë në organin tatimor përkatës bilancin e të ardhurave për efekt të tatimit vjetor.

Viti financiar mbaron në muajin dhjetor të çdo viti. Raportet dhe inventaret vjetore hartohen nga ortaku i vetëm në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe Legjislacionin në fuqi.

### **MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT**

#### **NENI 28**

Ortaku i vetëm vendos për personat që do të punësohen në aktivitetin e Shoqërisë. Punësimi do të bëhet në përputhje me aftësitë profesionale të punëmarrësit.

#### **NENI 29**

Marrëdhëniet e punësimit rregullohen sipas kontratës së punësimit që lidhet midis palëve, në bazë të Kodit të Punës dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në kontratë caktohen kushtet e punës, të pagesës, sigurimit në punë, ditëve të pushimit etj.

#### **NENI 30**

Administratori dhe personeli i Shoqërisë është i detyruar të respektojë disiplinën e punës, të ruajë dhe të mirëmbajë pronën dhe të zhvillojë aktivitetin e Shoqërisë në përputhje me ligjin.

#### **NENI 31**

Ndaj shkeljeve të ndryshme zbatohen masa disiplinore që merren nga ortaku i vetëm. Punonjësi që largohet nga puna duhet të bëjë dorëzimet e detyrës në bazë të një akti me shkrim, pasi të ketë shlyer detyrimet materiale dhe monetare.

### **PËRGJEGJËSIA E PUNONJËSVE**

#### **NENI 32**

Çdo punonjësë i punësuar në Shoqëri është personalisht përgjegjës për kryerjen e detyrës. Ai është i detyruar të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, nga vendimet e administratorit dhe nga Statuti i Shoqërisë. Për shkelje të tilla dhe për shkelje të Legjislacionit në fuqi merren masa të ndryshme sipas ligjit.

### **KONFIDENCIALITETI**

#### **NENI 33**

Të gjithë personat që do të punësohen në shoqëri janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e dokumentacionit, të informacionit, të njohurive të fituara si dhe të çdo lloj materiali tjetër konfidencial.

Ata duhet të adaptojnë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar hapjen e këtyre qoftë edhe pjesërisht.



## BILANCI DHE TË ARDHURAT

### NENI 34

Të ardhurat neto, pas shlyerjes së detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore dhe detyrimeve të mundshme ndaj personave të tretë, kalojnë në dispozicion të ortakut të vetëm Zotit Gëzim Qinami, i cili mund t'i depozitojë në një bankë të vendit ose të huaj, në lekë dhe valutë.

### NENI 35

Pagesat e personelit bëhen sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e punës dhe përqindjeve të fitimit të përcaktuara nga ortaku i vetëm.

### NENI 36

Në rast të mbarimit të veprimtarisë së Shoqërisë, fitimi i realizuar duke zbritur ose duke shtuar përqindjet e mbartura nga vitet e mëparshme, kalojnë në dispozicion të ortakut të vetëm Zotit Gëzim Qinami.

### Neni 37

Çmimet e shërbimeve të ofruara nga Shoqëria si dhe ato të tregtimit caktohen në bazë të parimeve të ekonomisë së tregut të lirë. Fitimet e realizuaraë i nënshtrohen tatimit vjetor të përcaktuar në dispozitat përkatëse ligjore.

## SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

### NENI 38

Veprimtaria e Shoqërisë mbaron me vendim të organit drejtues, në rast se veprimtaria e saj nuk rezulton fitimprurëse si dhe për shkaqe të parashikuara me ligj.

### NENI 39

Shoqëria mund të mbarojë edhe me anë të riorganizimit, nëpërmjet formave të thithjes ose të bashkimit.

### NENI 40

Gjatë fazës së likuidimit, përgjegjësia e administratorit dhe likuidatorit është e njëjtë.

## DISPOZITA TË FUNDIT

### NENI 41

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë institut sigurimi.

### NENI 42

Mosmarrëveshjet në marrëdhënie me persona juridikë e fizikë, vendas e të huaj, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt, gjykata kompetente është Gjykata e Rrethit Tiranë.

### NENI 43

Çdo gjë tjetër në këtë Shoqërië i referohet Ligjit Nr. 7638, datë 19. 11. 1992 dhe çdo akti tjetër të legjislacionit shqiptar.

**NENI 44**

Shoqëria do të ketë vulën e saj e cila përcaktohet nga ortaku i vetëm.

Statuti i Shoqërisë u miratua nga ortaku i vetëm dhe administratori i saj dhe u nënshkrua rregullisht prej tij.

**ORTAKU I VETËM DHE ADMINISTRATORI**

**Gëzim Qinami**

*Gëzim Qinami*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E NOTERËVE TIRANË


Nr. 112 Prot.

Nr. 24 Kol.

**V È R T E T I M**

Sot, në datë 21. 01. 2000 (dymijë), në Zyrën e Noterisë Tiranë, para meje noterit, u paraqit personalisht shtetasi **Gëzim Qinami**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar i njohur personalisht prej meje, i cili deklaroi se sa më sipër është Statuti i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "**UNION** " **SH.P.K.** i hartuar ne vullnetin e tij të lirë e të plotë, e nënshkruan para meje dhe unë noterit e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTER





**KËRKUESI** : **Gëzim Qinami**, i biri i Ramazanit, datëlindja 30. 04. 1946, lindur e banues në Tiranë, Rruga Zonja Çurre, Pall. 28, Shk. 2, Ap. 21, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

22691

**OBJEKTI** : Regjistrimi si person juridik të Shoqërisë tregtare "**UNION** " Sh.p.k.

Për kompetencë

**GJYKATËS SË RETHIT  
TIRANË**

*Te kërkesës për notat  
barkena  
Qinami  
21/1/2000*

Unë kërkuesi Gëzim Qinami, me cilësinë e Ortakut të vetëm dhe administrator  
një miratimin dhe regjistrimin si person juridik të shoqërisë private "**UNION** " Sh.p.k.  
kushtet e mëposhtme:

Emërtimi i shoqërisë private është "**UNION** " Sh.p.k.

Ortak i vetëm dhe administrator i Shoqërisë private do të jetë zoti **Gëzim Qinami**.  
Selia e Shoqërisë private do të jetë në adresën Rruga Zonja Çurre, Pall. 28, Shk. 2,  
21, Tiranë.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë private "**UNION** " Sh.p.k. do të jetë: Import-  
eksport dhe tregtimi me shumicë e pakicë i aparaturave elektronike, kompjutera,  
fotokopjues, faks, aparate telefonike e telefona celularë, televizorë, video, kamera,  
magnetofoni, pjesë këmbimi e asistencë teknike për to, kompakt-disco, video-  
games; kamçeleri; artikuj mobilerie; mallra industriale; produkte ushqimore, pije  
alkolike e freskuese; pjesë këmbimi për automjete; transport mallrash të të gjitha  
llojeve për vete dhe për të tretët brenda dhe jashtë vendit.

Kapitali fillestar do të jetë 100.000 lekë dhe do të depozitohet nga Ortaku i vetëm.  
Shoqëria private do ta zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 20 vjet.  
Veprimtaria e saj do të zhvillohet në Tiranë dhe do të shtrihet në të gjithë territorin e  
Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.


Bashkëngjitur me këtë kërkesë janë edhe dokumentat përkatës: Akti i themelimit  
dhe Statuti i Shoqërisë private "**UNION** " Sh.p.k.

**ORTAKU I VETËM DHE ADMINISTRATOR**

**GEZIM QINAMI**  
*Gëzim Qinami*

PUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË

Nr. 140 Rep.  
Nr. 22 Kol.



**V È R T E T I M**


Sot, në datë 21. 01. 2000 (dymijë) para meje noterit, u paraqit personalisht shtetasi  
**Gëzim Qinami**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i njohur prej  
meje, i cili deklaroi se sa më sipër është një kërkesë e hartuar me vullnetin e tij të lirë e të  
plotë, e nënshkruan rregullisht para meje dhe unë noterit e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTER



22.6P1/L

11.0P.00



J. F. Bajdo  
5/19/2000  
5 SET 2000

750 qari t'chit per llogaritje  
- vendim  
- kontakt  
Tirane  
ni 1.08.2000  
sejca kunders me 4.2.2000  
M. P. 2000  
Gjykatore G. Paj  
Kujdes

**KERKESE**

**1. KERKUESI :** Gezim QINAMI , i dtl. 1947, lindur dhe banues ne Tirane , Rr. Zonja Çurre , Pall. 28 , Shk. 2 , Ap. 21. Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me dokument identifikimi ( pasaporta ) me Nr. 0508364. Nen cilesine e Ortakut te Vetem te Shoqerise **UNION Sh.p.k.**

**OBJEKTI :** Kerkoj te depozitohet prane Gjykates Rrethit Tirane Vendimin **Nr. 1 date 09.06.2000** te Ortakut te vetem te Shoqerise "**UNION**" **Sh.p.k.** me ndryshimet perkatese konforme ligjit 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregetar " .

**Perpara : GJYKATES SE RRETHIT**

**TIRANE**

Me Vendimin **Nr. 122691 date 21.01.2000** te Gjykates te Rrethit Tirane, eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**UNION**" **Sh.p.k.**

Me vendimin **Nr. 1 date 04.09.2000** te Ortakut te vetem te Shoqerise eshte vendosur :

- Shitjen e 60 % te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise "**UNION**" **Sh.p.k.**
- Blerjen e kuotave perkatese te **z. Gezim QINAMI** nga Blereset **Natasha QINAMI** dhe **Edlira HASKAJ** ne masen 30 % sejcila .
- Blereset pranohen si Ortake te Reja ne Shoqerine **UNION Sh.p.k.**
- **Z. Gezim QINAMI** mbetet ne Shoqeri si Ortak duke disponuar 40 % te kuotave te kapitalit fillestar te Shoqerise dhe duke qene Administrator i kesaj Shoqerie . .
- Te ruaje te pandryshuara te gjitha dispozitat e tjera te paraqitura ne Statutin e Shoqerise.
- Te njoftohet Gjykata e Rrethit Tirane , per te bere ndryshimet perkatese ne regjistrin tregetar te Shoqerise .

**K E R K U E S I**

**Gezim QINAMI**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**NOTERIA TIRANE**

Nr. 4709 Rep.

Nr. - Kol.

**VERTETIM**

Vertetohet se sot me date 04 . 09.2000( dy mije ) u paraqit personalisht para meje noteres N. Murat me Studio ne Bul. Zhan D'Ark shtetasi :

1. **Gezim QINAMI** , i dtl. 1947, lindur dhe banues ne Tirane , Rr. Zonja Çurre , Pall. 28 , Shk. 2 , Ap. 21. Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , me dokument identifikimi ( pasaporta ) me Nr. 0508364.  
Nen cilesine e Ortakut te Vetem te Shoqerise **UNION Sh.p.k.**


i cili nenshkroi rregullisht para meje Noterit **Kerkesen** drejtuar Gjykates se Rrethit Tirane lidhur me depozitimin e ndryshimeve te Shoqerise **UNION Sh.p.k.** perpiluar jashte kesaj zyre dhe une , Noteri duke e gjetur ate konforme ligjit e vertetoj dhe e nenshkruaj .



**NOTERE**

*Gezim Murat*

*[Signature]*






Me datë 1 Nentor 2002 u lidh kontrata e shitjes se kuotave, ne permbushje te vendimit te marre nga Asambleja.

